

Bajram Muçaj, njeriu që bëri epokë financiare në Shqipëri



Fondi BESA është një nga institucionet lider në financimin e bizneseve të vogla në Shqipëri. Me një aktivitet prej më shumë se 20 vitesh, Fondi BESA mund të cilësohet një nga projektet ekonomike që ka rezultuar efikas për bizneset më shumë sesa edhe vetë qeveritë. Pos si funksionon ky institucion financiar dhe cilat janë "sekretet" e suksesit që e kanë kthyer në një prej më të rëndësishmëve për zhvillimin e biznesve mikro në vend? Drejtori Ekzekutiv i Fondit BESA, Bajram Muçaj, në një intervistë ekskluzive për "Koha Jone" rrëfen për menaxhimin e këtij institucioni dhe për projektet e ardhshme.

Fondi BESA është me shumë emër në tregun financiar shqiptar, por a mund të na thoni pse jeni institucion financiar, e jo bankë? Dhe ku është ndryshimi mes bankës dhe institucionit financiar jo bankë, që ta mësojnë

jet kredive të vogla ngritjen e bizneseve mikro, të vogla dhe veçanërisht nëpërmjet vetë-punësimit, kryesisht në zonat rreth qyteteve të mëdha, në qytetet e vogla dhe zonat rurale.

Lëvizjet demografike pas viteve 1990,

emergjente nga njëra anë dhe ofrimi i parasë nga bankat ishte tepër i kufizuar nga ana tjetër. Kjo edhe për faktin se kjo pjesë tashmë e krijuar e klientelës/tregut kishte disa veçori të cilat e kufizonin kreditimin e tyre nga sistemi bankar.

Së pari, këto biznese janë shumë të vogla për nga aktiviteti dhe asetet që disponojnë; së dyti, të ardhurat që ato krijojnë janë të papërfillshme në tregun e konkurrencës; së treti, janë biznese pa "rekordet" financiare dhe historik të konsoliduar dhe për më tepër, garancitë që ofrojnë në disponibilitetin dhe llojet e kolateralit janë tepër të dobëta tek kjo shtresë e popullsisë. Pra siç kuptohet, domosdoshmëria e këtyre institucioneve erdhi si një kërkesë e natyrshme për të operuar në këtë pjesë të tregut të kreditit të plotësuar shumë pak ose aspak me burime të financimit përmes kredive.

Ligji "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", si dhe rregulloret e Bankës së Shqipërisë, këto institucione i emërton Subjekte Financiare Jobankë. Këto institucione emërtohen kështu kryesisht për faktin e kufizimeve të veprimtarive/produkteve bazë që ato ofrojnë, ku më kryesorit që nuk u lejohet është mbledhja dhe administrimi i depozitave, si një nga burimet kryesore të fondeve të bankave. Për institucionet si Fondi BESA, burimet e fondeve janë kryesisht fondet e veta/aksionerët, ku ndër më kryesorët është ai i fondeve të huazuara nga tregu ndërkombëtar, si dhe ai vendas, ku ai bankar është më prezenti.

Fondi BESA deri në fund të vitit 2014 ka dhënë 400 milionë USD kredi për rreth 128.000 kredi të dhëna. A keni probleme në arkëtimin e kredisë nga kredimarrësit, ose më saktë, janë korrek të në shlyerjen e kësteve?

Në teorinë e kredisë thuhet se "Kredi pa risk nuk ka". Kjo shpjegohet me konceptin e riskut. Aq më tepër, për një kontigjent klientele që përshkruan më sipër. Por nga ana tjetër, ky kontigjent klientele ka anë të pozitive të tij, pasi madhësia/shuma e detyrimit/këstit muaj apo periodik të shlyerjes është më i mundshëm për t'u shlyer, duke marrë në konsideratë edhe burimet financiare dytësore të familjeve. Po kështu, propabiliteti i rrezikut të dështimit në këto biznese

është i lartë, por përshtatja dhe mbijetesa e këtyre bizneseve në treg është gjithashtu më e lartë. Gjithashtu, duhet theksuar që përgjegjësia ndaj detyrimit e kësaj klientele është më e lartë. Pa dyshim, që baza e kreditimit të këtyre bizneseve është aktiviteti dhe besimi reciprok midis klientit dhe oficerit të kredisë, gjë e cila tek ne ka funksionuar më së miri.

Siç dihet, në kohë krizash, më i varfëri e ndjen më fort atë. Kjo është si puna e varkës dhe anijes në një det të trazuar. Por faktet kanë treguar që nëse sistemi bankar e ka treguesin e kredive me probleme në rreth 24%, Fondi BESA e ka këtë tregues të rëndësishëm të cilësisë të portofolit të kredisë në rreth 7%, sipas standardeve të njëjta me ato të bankave në nivelin të dytë. Këtë rezultat ia dedikojmë përkushtimit dhe profesionalizmit të stafit të Fondit BESA dhe sidomos procedurave transparente dhe të mirëdizenuara.

Ju keni politikë financiare që i jepni kredi biznesit të vogël dhe të mesëm duke synuar edhe një politikë sociale, pra që të kontribuoni në zvogëlimin e varfërisë. Mos jeni si një qeveri që nuk votoheni, por që shkonin tek populli me kredi që të zhvillohet Shqipëria?

Përcaktimi që i bëni misionit tonë është mëse i saktë. Pikërisht, ky ka qenë edhe qëllimi i ngritjes së këtij institucioni. Misioni i Fondit BESA është të ndihmojë në rritjen ekonomike dhe reduktimin e varfërisë së vendit në zonat urbane dhe gjysmë-urbane, duke promovuar ndërmarrjet mikro dhe të vogla në Shqipëri, nëpërmjet financimit të tyre me mikrokredi, si dhe bizneset e mesme këto vitet e fundit. Fondi BESA siguron gjithashtu edhe asistencë teknike për sipërmarrësit, përfshirë kualifikimin e tyre. Duke zbatuar këtë mision, Fondi BESA jep kontributin e tij për krijimin e vendeve të punës, çka konsiderohet të jetë një faktor i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe social, si nëpërmjet zbatjes së varfërisë, ashtu edhe përmes integrimit social. Ne jemi duke u përpjekur të jetë një faktor i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe ato sociale, duke i përfshirë grupet e marginalizuara për t'u angazhuar në sipërmarrjen prodhuese nga njëra anë dhe ruajtjen e sigurimin e shë-

(Vijon në faqen 11)



Drejtori Ekzekutiv i Fondit BESA, Bajram Muçaj

lexuesit?

Për t'u përgjigjur pyetjes tuaj, duhet bërë një përshkrim mbi historikun e institucioneve të këtij lloji dhe Fondit BESA në veçanti, por unë do mundohem ta përmbledh shkurtimisht.

Krijimi i Fondit BESA, si dhe i institucioneve të ngjashme në Shqipëri, e ka zanafillën që në vitet 1994, nën projektin dhe stimulimin e Bankës Botërore, për të financuar nëpërm-

bënë që një pjesë e popullsisë t'i drejtohej zonave urbane dhe qendrave të qyteteve, kryesisht të mëdha, si dhe të ridimensionohej ekonomia bujqësore, tashmë në një realitet të ri ekonomik, nëpërmjet vetë-punësimit në bujqësi dhe ngritjes së fermave të vogla bujqësore. Kjo pjesë e popullsisë kishte dhe ka disa specifika në marrëdhëniet me bankat dhe institucionet e tjera financiare, pasi nevojat/kërkesat e tyre për para' ishin



Gjatë dekorimit të Fondit Besa nga Presidenti Bamir Topi

(Vijon nga faqja 10)

bimeve financiare afatgjata për klientët nga ana tjetër. Sigurisht që Fondi BESA nuk është si një qeveri, por jemi biznes si gjithë bizneset e tjera, por në këndvështrimin e votës, ne votohemi nëpërmjet korrektësisë së klientëve tanë në shlyerjen e kësteve të kredisë. Fondi BESA ka pesë vlera themelore, të cilat rrjedhin natyrshëm nga misioni dhe qëllimet e tij: Respekti, Integriteti, Transparenca, Profesionalizmi dhe Vetë-Qëndrueshmëria. Bazuar në vlera të tilla, Fondi BESA ofron shërbime financiare që kërkohen nga klientët në zonat urbane dhe gjysmë urbane të Shqipërisë.

A jeni shtrirë në çdo rreth të Shqipërisë apo vetëm në qytetet kryesore? Në cilat zona të Shqipërisë keni dhënë me shumë kredi dhe sa është numri i të punësuarve në vend si pasojë e mikrokredive tuaja? Keni një bilanc apo keni interes vetëm të dini se cili merr kredinë?

Fondi BESA operon pothuajse në të gjithë territorin e vendit dhe aktiviteti i tij është i shtrirë në 67 zryra me mbi 400 punonjës në të gjithë Shqipërinë. Përqendrimi më i lartë i kredidhënies, ose rreth 50% e outstandingut sot është i financuar në prefekturat Tiranë, Durës, dhe Elbasan, ku janë përqendruar edhe bizneset dhe popullsia më e madhe e vendit. Gjithashtu, ne jemi të shtrirë që nga Hasi në Kukës, Peshkopi, Malësi e Madhe e deri në Himarë, Sarandë, Devoll etj. Nga analiza që ne i kemi bërë aktivitetit të një viti rezultoi se kreditimi që ofron Fondi BESA krijon rreth 4.500-5.000 vende pune.

E gjithë veprimtaria jonë udhëhiqet nga qëllimi kryesor; sigurimi i aksesit në produktet dhe shërbimet financiare për bizneset e vogla dhe të mesme. Ky qëllim mishërohet në biznesplanet vjetorë dhe ata afatmesëm, zakonisht 3-5 vjet.

Strategjia kryesore për të ardhmen vazhdon të jetë forcimi i veprimtarisë bazë – ajo e huadhënies, duke vazhduar të mbetemi një nga aktorët më të rëndësishëm në sektorin mikrofinanciar në Shqipëri. Nën statusin e një institucioni financiar jo bankë, Fondi BESA po eksploron mundësitë për të zgjeruar gamën e produkteve dhe të shërbimeve financiare, si edhe zgjerimin e zonës së ndërhyrjes.

Me qëllim zgjerimin e aktivitetit, Fondi BESA implementon një strategji dyfishë: (I) nëpërmjet rritjes së bazës së klientelës, kryesisht nëpërmjet tërheqjes në sistemin të klientëve të rinj, të cilët përbëjnë një “bërthamë” të rëndësishme për rritjen e aktivitetit në kredidhënie në periudhën “afat-mesme” dhe për më tepër, një “treg të siguruar” për një paketë të re produktesh dhe shërbimesh që mundësohen në kuadrin e statusit ekzistues; (II) nëpërmjet zgjerimit të aktivitetit huadhënës në zona të reja geografike dhe hapur zryra rajonale dhe agjenci të reja me qëllim që të jemi sa më afër nevojave të klientelës për t’iu përgjigjur atyre në kohën e duhur. Në të njëjtën kohë, Fondi BESA po konsideron mundësinë e diversifikimit të mëtejshëm të produkteve si një rrugë për zgjerimin e aktivitetit si në zonat ekzistuese, ashtu edhe në ato të reja. Bazuar në biznesplanin e vitit 2015, kreditimi nga Fondi BESA do të rritet edhe me rreth 10 milionë USD, ose me një rritje prej rreth 17.5%. Ndërsa për 3 vitet e ardhshme ne synojmë të disbursojmë rreth 220 milionë USD, në ndihmë të sipërmarrjes së vogël dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale. Gjithashtu, realizimi i këtyre objektivave do të shoqërohet edhe me përmirësimin e vetë-qëndrueshmërisë financiare në pesë vitet e ardhshme. Ruajtja e treguesve dhe indikatorëve në përputhje me rregulloret e mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë. Ruajtja e një portofoli në risk jo më shumë se 4%

në pesë vitet e ardhshme, etj. **Mundet të përshkruani një panoramë të shkurtër se si e jepni një kredi, që ta mësojnë edhe më shumë njerëzit?**

Fillimisht po bëjmë një përshkrim të shkurtër të produkteve që Fondi BESA ofron për klientët e tij:

• **“Kredi Biznesi”** ka si qëllim të financojë çdo lloj biznesi të vogël apo mikro që gjeneron të ardhura si tregti dhe shërbime, aktivitetet prodhuese dhe përpunuese, turizëm familjar, ndërtim dhe riparime, transport etj. Këto janë kredi individuale.

• **“Kredia për rininë”** – një produkt specifik për rininë, që ka si qëllim t’u japë të rinjve një mundësi për integrimin e tyre në shoqëri nëpërmjet mundësisë për t’u vetëpunësuar.

• **“Kredi konsumatore”** – ka si qëllim financimin për qëllime konsumatore.

• **“Kredi për efikasitetin e energjisë”** që kanë si qëllim promovimin e investimeve në biznese që inkurajojnë përdorimin eficient dhe kurisimin e elektricitetit.

Në të njëjtën kohë, Fondi BESA, zbaton një sërë projektesh në bashkëpunim me partnerët e huaj, nën të cilët ofron produkte specifike kredie si: Kredi Biznesi nën projektin “Krijimi i shoqatave të integruar rural në komunat rurale të Shqipërisë Veriore”; Kredi Biznesi nën projektin “Zhvillimi i integruar rural në komunat Shkrel dhe Kelmend në rrethin e Malësisë së Madhe dhe në Përmet” me Kooperacionin Italian dhe Kredi nën projektin “Eficienca e Energjisë në Banesa” në bashkëpunim me IFC.

Që të përfitosh kredi nga Fondi BESA është shumë e thjeshtë, pasi ne operojmë me shpejtësi dhe lehtësi për klientin në plotësimin e kushteve më të domosdoshme të kredisë. Kështu, përzgjedhja e klientelës bëhet kryesisht nga puna e oficerëve të kredisë në terren, pranë bizneseve, qytetarëve dhe në zyrat e Fondit BESA. Për ne, klient për kredi është çdo shtetas shqiptar

apo rezident i huaj në Shqipëri, i cili ka një biznes të licencuar, apo kërkon kredi konsumatore etj dhe identifikohet me të gjitha dokumentet ligjore më të domosdoshëm, si certifikatë familjare, kartë identiteti apo pasaportë, gjeneralitete të tjera civile dhe profesionale, vendbanimi dhe qendra e biznesit të vërtetuar, të dhëna ekonomike e financiare mbi biznesin e ato familjare, marrëdhëniet dhe detyrimet me institucione të tjera dhe shtetin dhe garancinë për kredinë. Tek garancia, Fondi BESA është nga institucionet më lehtësues për klientët, pasi po të shikoni portofolin tonë rezultoni se rreth 85% e klientëve e garantojnë kredinë me kolateral peng. Kjo e fundit shpjegohet me faktin se në mikrofinancë, baza e kredidhënies është besimi reciprok midis klientit dhe oficerit të kredisë. Pra, si konkluzion që të përfitosh kredi te Fondi BESA dy janë elementët bazë: 1) besimi të karakteri dhe 2) norma e borxhit ose raporti borxhe mbi të ardhurat. Çdo qytetar e ka shumë të thjeshtë të njihet me kushtet e kredimarrjes në Fondin BESA, pasi përveç kontaktit me punonjësit tanë në terren apo zyrat e Fondit, mund të hyjë në faqen tonë zyrtare në internet dhe aty njihet menjëherë se si merret kredia. www.fondiBESA.com

Në Fondin BESA, kredia merret për 3-5 ditë, ndërsa për klientët të përsëritur jo më shumë se 3 ditë.

Ju e jepni kredinë, por a e kontrolloni, edhe duke e ndihmuar, personin që merr kredinë? Me pak fjalë, ju vetëm e jepni, por a jeni edhe konsultues se si mund ta zhvillojë biznesin kredimarrësi? Pyetje shumë e drejtë. Siç e thashë edhe më lart, një nga elementët e licencës nga Banka e Shqipërisë është dhe veprimtaria e konsulentëve. Përveç trajnimit të vazhdueshëm që ne i bëjmë stafit tonë, ne jemi me fat që kemi një staf tepër profesional dhe të përgjegjshëm. Ne kemi bindjen se bizneset kanë nevojë në vazhdimësi të bashkëpunojnë dhe këshillohen me specialistë të kualifikuar në fushën e menaxhimit dhe sidomos të menaxhimit financiar. Për aq kohë sa Fondi BESA financon me kredi aktivitetin e një biznesi, ai bëhet një bashkëpunues i rëndësishëm, pasi interesat për mirëadministrimin e parave të kredituara janë të përbashkëta. Nga njëra anë, klienti për të zhvilluar biznesin e për të fituar dhe nga ana tjetër, oficeri i kredisë për të kredituar dhe kthyer kredinë, bashkë me interesin.

Gjatë jetëgjatësisë së kredisë bizneset hasen edhe me vështirësi, e shpesh gjenden në pozicione tepër të vështira. Pikërisht në këto momente, të gjendurit pranë bizneseve merr një rëndësi të veçantë. Ne i analizojmë dhe i konsultojmë ata se si duhet të veprojnë në gjetjen e rrugëve mbi përdorimin e aseteve me vesh-

pak kosto për të rregulluar situatat, shpesh të papritura, ashtu siç edhe përdorim metodat tona të ndihmës financiare, nëpërmjet rishtrukturuimeve të kredisë, apo rirfinancimeve për të ndihmuar në vazhdimin normal të biznesit të tyre. Kjo metodë punë na ka dhënë rezultat dhe po të shikoni në portofolin tonë do të gjeni klientët që kanë marrë kredi edhe 10 apo 13 herë. Me ne janë rritur shumë biznese. Po ju them një rast në Shkodër. Një klient shumë punëtor dhe i ndershtëm, e nisi biznesin para 15 vjetësh duke shitur në trotuar, pastaj me kredi nga ne bëri një kioskë, më vonë po me kredi nga ne bëri një dyqan të vogël dhe sot ka një dyqan shumë të mirë dhe vazhdon me sukses biznesin e tij në fushën e tregtisë me pakicë.

Ka rreth 6 vjet që kur Fondi BESA është bërë shoqëri aksionere dhe paralellisht është krijuar Fondacioni Albania BESA Capital, i cili është trashëgimtari i Fondacionit BESA, por pa të drejtë kredidhënie. Ky institucion merret edhe me trajnimin e bizneseve dhe veçanërisht të grave biznesmene, artizanëve, romëve, të rinjve dhe shtresave më në nevojë, për t’i mësuar se si të ngrejnë një biznes dhe si ta zhvillojnë më tej atë.

Në cilët sektorë jepni me shumë kredi? Në tregti, shërbime, bujqësi, blegtori, zejтари apo ku?

Baza e klientelës sonë janë bizneset me pakicë në tregti dhe shërbime, ku përfshihen edhe artizanët dhe zejtarët. Gjithashtu, ne jemi fokusuar mirë edhe në industrinë e fasonëve, atë ushqimorë, transport, ndërtim, etj. Po lë në fund bujqësinë dhe blegtorinë, pasi deri sot që flasim, vetëm rreth 6% e portofolit është financuar në këtë fushë. Sidomos, janë preferuar zonat e Myzeqesë, Devollit, Shkodrës, Malësi e Madhe, Peshkopisë, etj. Kjo ka patur shumë arsye, të cilat kanë të bëjnë me normën e kthimit në bujqësi apo problemet e pronësisë së tokës etj. Por më kryesorja është se ne kemi qenë të specializuar më shumë në bizneset në rrethinat e qyteteve, sesa në bujqësi dhe blegtori. Por sot që flasim jemi pikërisht në kohën kur ne sapo kemi lançar produktet tona në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë. Ne mendojmë se ka ardhur koha që sektori i bujqësisë dhe blegtorisë duhet kredituar dhe financiar me të gjitha mënyrat si nga institucionet financiare e bankare ashtu dhe ato publike, pasi ky sektor është një nga burimet kryesore të zhvillimit të mirëqenies si dhe të ekonomisë në përgjithësi.

Sot kushtet e fermerëve kanë ndryshuar, ato janë konsoliduar, falë reformave në bujqësi, si ajo e pronës së tokës, ashtu edhe falë rritjes së njohurive dhe marrjes së eksperiencave nga jashtë dhe brenda vendit, si edhe pritsh-

(Vijon në faqen 12)

INTERVISTA

(Vijon nga faqja 11)

INTERVISTA

mërive për financime nga Komiteti Europian, pas hapjes së derës për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Puna juaj si Fondi BESA ka ndonjë qoshë që konverton me interesat e qeverive, apo jeni krejtësisht pa interes se kush është në qeveri?

Pa diskutim që puna jonë është në të njëjtën linjë me atë të qeverisë, si asaj të shkuar dhe kësaj që është sot. Të gjitha qeveritë janë të interesuara për zhvillimin e biznesit të vogël dhe të mesëm, bile në programet e tyre kjo është një pikë e rëndësishme. Për ne nuk ka rëndësi se kush është në qeveri, për ne rëndësi ka që qeveria, si e djathtë apo e majtë, të krijojë kushte që sektori i mikrofinancës dhe veçanërisht ai i mikrokredisë, të zhvillohet sa më shëndetshëm. Për këtë qëllim ne jemi duke bashkëpunuar me qeverinë në lidhje me projekte të përbashkëta si me donatorë të huaj, ashtu edhe me vetë qeverinë. Një nga këto projekte është edhe në fushën e bujqësisë, për subvencionimin e një pjese të interesave për fermerët, apo për financimin e bizneseve të mesme për blerjen e pajisjeve dhe makinerive të biznesit nga fondet e qeverisë Italiane, KfV apo projekti të Bashkimit Evropian.

Vitin që kaloi ishte qeveria shqiptare që ndërmjetësoi që për herë të parë një institucion i mikrofinancës, pra Fondi BESA, të nënshkruajë një marrëveshje huaje për financimin e bizneseve të vogla dhe të

miisht duhet të kesh kapitalin e mjaftueshëm, që për institucione si Fondi BESA, kërkohet një kohë e gjatë për ta krijuar, pasi dhe norma e fitimit e këtyre institucioneve është më e ulët në tregun financiar. Nga ana tjetër, kostot e ngritjes së një banke, për kushtet moderne të sotme janë të konsiderueshme, po kështu edhe përgatitja e një stafi me bankierë për të operuar me të gjitha produktet e një banke kërkojnë kohën e nevojshme dhe koston e tyre. Dihet se një nga veprimtaritë kryesore të bankave është mbledhja e depozitave, gjë të cilën këto institucione nuk e kanë, sepse nuk e lejon ligji. Fillimi i një veprimtarie të tillë kërkon përgatitje të stafit dhe infrastrukturën e nevojshme, konform standardeve të kërkesave të BSH. Të gjitha këto sa thamë më sipër, duhen përgatitur me kujdes dhe me llogaritje të sakta.

Fondi BESA e ka studiuar me kujdes, si përvorjen e vendeve të tjera, ashtu dhe mundësinë e transformimit të tij në një institucion bankar. Ne mendojmë që hapat duhen hedhur një nga një. Kështu, eksperiencat e vendeve të tjera, për krijimin e bankave mikrofinanciare, janë më të përshtatshmet për vende në zhvillim si Shqipëria. Ligji tek ne nuk e ka parashikuar një gjë të tillë. Këto lloj bankash kanë specifikat e tyre dhe janë të segmentuara me shërbime pikërisht në tregun e mikrofinancës me të gjitha produktet bankare, por me kufizimet që përmban vetë ky treg. Ky tip ndërmjetësish financiarë nuk janë një zbulim i ri në tregun botëror financiar, ndërsa për Sh-



Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Ilir Meta dhe Drejtori Ekzekutiv i Fondit BESA, Bajram Muçaj, gjatë ceremonisë së inaugurimit të këndit të lojërave në Çorovodë

nivellit të dytë. Kjo për faktin se humbet misioni dhe qëllimi për të cilin këto institucione janë krijuar dhe së dyti, Fondi BESA ka një "kontratë" me klientelën e tij, gjë e cila është një pasuri e krijuar ndër vite dhe që nuk duhet abandonuar apo anashkaluar. Përsa u përket taksave, jemi në të njëjtin nivel me atë të sistemit bankar, në një kohë kur norma e fitimit e institucioneve si Fondi BESA është shumë më e ulët. Dhe kjo dihet, që kostot e fondeve dhe shpenzimet operacionale tek ne janë më të larta se ato të bankave. Psh. nëse analizojmë sot kostot e fondeve nga depozitat që marrin bankat, krahasuar me kostot e fondeve të huazuara nga institucione apo banka ndërkombëtare si dhe ato brenda vendit, që marrin institucionet tona, diferenca është me 6-7% më të larta për fondet që sigurojnë institucionet mikrofinanciare. Nga ana tjetër, bankat kanë edhe shërbime të tjera, për të cilat kanë të ardhura nga komisionet bankare, ndërsa institucionet si Fondi BESA nuk i kanë ato, në një kohë kur tati mi fitimin është i njëjtë 15% si për bankat, ashtu dhe për Fondin BESA dhe institucione të tjera financiare.

Jeni dekoruar nga Presidenti i Republikës si institucion, keni marrë çmime nga institucione financiare prestigjioze të huaja, por edhe nga Shqipëria. Të gjitha këto janë marrë me meritë, apo si shkak i lobjejeve të forta financiare që ju keni?

Disa nga çmimet dhe dekorimet që ka marrë Fondi BESA janë:

- 2007 – Fondi BESA sh.a është klasifikuar si një nga 50 institucionet më të mira financiare në botë sipas revistës Forbes.
- Qershor 27, 2011 (Frankfurt – Gjermani) Fondi BESA sh.a u nderua me çmimin e veçantë "HARKU I EUROPËS PËR CILËSI DHE TEKNOLOGJI" NË KATEGORINË E ARTË për kontribut të pamash në botën e biznesit, për profesionalizëm të lartë të demonstruar me një performancë prestigjioze.
- Mars 11, 2012 – (Gjenevë, Zvërvër) Fondi BESA sh.a u nderua nga Business Initiative Directions me Çmimin Century International

Platinum Quality Era në lidhje me Kënaqësinë Konsumatore, Leadershipin, Planifikimin Strategjik dhe Standartet.

• Prill 10, 2012 – Presidenti i Republikës së Shqipërisë i akordoi Fondit BESA sh.a "Medaljen e Mirënjohjes" me rastin e 13-vjetorit të krijimit të "Për kontribut në zbutjen e varfërisë, promovimin e vetë punësimit dhe punësimit, nëpërmjet financimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Shqipëri."

• Dhjetor 2012, Fondi BESA Fund u nderua nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë "Për përmbushjen me efektivitet të misionit të tij në mbështetjen e zhvillimit ekonomik dhe zbutjen e varfërisë; për promovimin e sektorit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Shqipëri; Për sigurimin e aksesit në mikrokredi për të gjithë shtresat sociale ekonomike, përfshirë të papunët dhe bizneset start-up".

Ne jemi të bindur se kontributi i stafit të Fondit BESA, i ka merituar të gjitha këto vlerësime të punës së tij 20-vjeçare. Të ndihmohet më pak të ndihmuarit, në biznes apo në familje, me para kur si kanë dhe kur ju duhen është sa një bamirësi, aq edhe një shikim nga e ardhmja për këta qytetarë të thjeshtë, apo bizneset e tyre. Unë mendoj se Fondi BESA nuk ka patur dhe nuk do ketë nevojë për lobjingje, për aq kohë sa njerëzit i ndiejnë dhe i prekin rezultatet e punës tonë dhe mbas kësaj vlerësimi vjen vetë.

Jepni kredi, por a i keni dhënë jo kredi ndonjë personi apo ndokujt tjetër që ka kërkuar ndihmë nga Ju, flasin për nevojat jetike?

Kjo pyetje ndoshta do duhej të ishte më e qartë. Pasi bëhet fjalë për nevojat jetike familjare për mbijetesë, nevoja jetike për mosfalimentim në biznes, apo ndonjë nevojë tjetër jetike? Megjithatë, duhet theksuar edhe një herë se Fondi BESA ka objektivat dhe mbi këto objektivat ka ndërtuar strategjitë e tij, për të ndihmuar në zbutjen e varfërisë dhe zhvillimin e biznesit të vogël dhe shumë të vogël, tashmë dhe atë të mesëm, nëpërmjet rregullave të përcaktuara qartë, konform standardeve më të mira ndërkomb-

(Vijon në faqe 13)



Drejtori Ekzekutiv i Fondit BESA, Bajram Muçaj, Presidenti i Bankës Deti i Zi, Mustafa Boran dhe Ministri i Bujqësisë, Edmond Panariti, gjatë nënshkrimit të një marrëveshjeje për financimin e bizneseve mikro në SME, organizuar nga Fondi Besa.

mesme, me Bankën e Detit të Zi, për 6 milionë euro.

Prapë insistoj se përse nuk jeni bankë, por vetëm institucion financiar? Paguani më pak taksë kështu, apo pse?

Ligji për sistemin bankar në Shqipëri përcakton kushtet që duhen plotësuar për të krijuar një bankë. Në historinë e institucioneve të tilla si Fondi BESA, në vende të tjera, ka raste që kthehen në banka tregtare, apo banka mikro-financiare. Çdo vend ka specifikat e tij. Sigurisht që sipas ligjit, që të bëhesh bankë filli-

qipërinë do të ishte një plotësim i tregut financiar për ndërmjetësimin e fondeve nga njësitet suficitare tek ato deficiitare, gjithnjë duke u fokusuar tek biznesi mikro, i vogël dhe ai i mesëm. Sigurisht, kjo nisim kërkon edhe nisma të tjera ligjore dhe rregullative, ku roli i Bankës Qendrore është deciziv në këtë drejtim.

Mendoj që sot më i rëndësishëm është diversifikimi i institucioneve Financiare sesa polarizimi i tyre dhe aq më tepër, grupimi në statusin e këtyre institucioneve si banka të





INTERVISTA

(Vijon nga faqja 12)

mbëtare dhe kërkesave të Bankës së Shqipërisë. Fondi BESA është dhe bën biznes si gjithë institucionet e tjera financiare. Bërja biznes do të thotë rezultat financiar pozitiv në fund të periudhës ushtrimore. Por kjo nuk na ka bërë të ngurtë, për të mos ndihmuar edhe nevojtarë për mbijetesë, si familje të varfra, ashtu edhe kreditim të ndonjë biznesi për mbijetesë me shpresën e rimëkëmbjes së tij. Raste të tilla kemi patur dhe ndihma kemi dhënë. Qëllimi ynë nuk është tlu japin asistencë të tjerëve sado të varfër të jenë, por t'i mësojmë ata si të bëjnë biznes duke u vetëpunësuar në mikro apo biznes të vogël dhe të bëhen të aftë të ndiejnë fitimin nga puna e tyre në ekonominë e tregut, me qëllimin e vetëm të rritjes së mirëqenies së tyre. Nëse ata do të fitojnë nga kjo, edhe ne do të fitojmë, sadopak, por do të fitojnë të gjithë.

Në vijim të pyetjes së mësipërme do të ishte me interes të dinim sesa aktiv është Fondi BESA sh.a. në implementimin dhe përmbushjen e "përgjegjësisë sociale" të kompanisë?

Angazhimi i Fondit BESA në aktivitete me përgjegjësi sociale reflekton orientimin e institucionit drejt ruajtjes së një balance midis objektivave sociale dhe atyre financiare. Me të drejtë sh-

trohet kjo pyetje, pasi sot jo të gjitha kompanitë që operojnë në sektorin financiar apo në sektorë dhe industri të ndryshme janë aktive dhe të "ndjeshëm" në implementimin e përgjegjësisë sociale. Unë mund të them se Fondi BESA gjithmonë e ka parë këtë aspekt si një pjesë të aktivitetit që ndikon në "imazhin" e kompanisë dhe ndërtimin e përmirësimit e marrëdhënieve me publikun.

Në këtë kuadër, mund të përmend kontributin financiar të dhënë nga Fondi BESA për shokatën shqiptare Alpinistiko-Turistike në iniciativat e tyre në ngjitjen e majave më të larta të botës. Pjesë e realizimit të "përgjegjësisë sociale" janë financimet e realizuara nga Fondi BESA në kohë të ndryshme për të garantuar paketa ushqimore në ndihmë të banorëve të zonave të përmbytura në veri dhe në jug të vendit, madje edhe në Tiranë në një rast përmbytje në Njësinë Minibashkiakë Nr 5. Vlen të përmendet investimi i bërë në bashkëpunim me Ministrinë e Mirëqenies Sociale për të mundësuar realizimin e një projekti për sistemimin e romëve me ambiente banimi në Tiranë. Pjesëmarrje tjetër e rëndësishme e Fondit BESA ka qenë financimi për riparimin e godinës së Ish-të Përmjekurve Politikë.

Brenda këtyre investimeve vlen të përmendet investimi i Fondit BESA për riparimin e ambi-



Drejtori Ekzekutiv i Fondit BESA, Bajram Muçaj me ministrin e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Erion Vellaj me fëmijët romë

enteve të Drejtorisë së Policisë të Qarkut Tiranë, investim i cili mundësoi shndërrimin e kësaj godine në një ambient bashkëkohor dhe dinjitoz në shërbim të qytetarëve. Pjesë e kontributit të Fondit BESA në përmbushje të përgjegjësisë sociale ishte edhe investimi i bërë në bashkëpunim me Bashkinë Çorovodë për të ndërtuar dhe kompletuar me pajisje një kënd lojërash në qendër të qytetit, si një mundësi e re për argëtimin e fëmijëve të këtij qyteti.

Duke patur kaq shumë klientë e kaq shumë popullaritet për shkak edhe të intere-

save që kanë prej jush, a ju ka vajtur mendja se mund të jeni edhe deputet? Më saktë, a ju ka propozuar ndonjë parti? Siç përmenda më sipër, Fondi BESA ka një "kontratë" me klientët e tij, ndërsa unë kam një kontratë me klientët dhe punonjësit, ndaj dua t'i qëndroj "bensnik" kësaj kontrate në funksion të zhvillimit të institucionit dhe ndihmës e zhvillimit të sipërmarrjes së vogël dhe të mesme. Unë në punën time jam rritur dhe ballafaquar me vështirësitë dhe i tillë do mbetem në të ardhmen.

Ju jeni si një lloj "ministri Fi-

nancash" në mbretërinë tuaj financiare. Nëse do ju propozonin vërtet për ministër Financash të Shqipërisë a do ta mendonit?

Lidhur me këtë pyetje dua të them që Ministri i Financave, Shkëlqim Cani, një person me përvojë të gjatë në fushën financiare dhe akademike, i cili është një ndër "promotorët" e iniciativave në mbështetje të zhvillimit të industrisë së mikrofinancës në Shqipëri, unë me njohjen time profesionale, gjithashtu si shok dhe si mik, i uroj suksese në detyrën e tij.

